



Pranimi / Dorezimi Prinjeni / Prodato Received / Delivery	26.04.2023	3	Vendi Lokali Vendi
Organ / Shërbimi Organ / Shërbimi Org / Shërb	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No	Shtesa / Prilog Appendix	Sasia Kopimit Quantity
SKIMSHER	3854/2023		1/10



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.408/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.408/2023 të datës 23.02.2023 të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në çështjen juridike "Vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 26.04.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.408/2023 e datës 23.02.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Ndryshohet Formulari i datës 24.01.2023 dhe i gjeneruar në SIMBNJ më datë 27.01.2023 për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen, lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit, dhe atë nga vlerësimi (1.3)-dobët, në vlerësimin (3) -mirë.
- III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesen si në pikën II të dispozitivit, ndërsa obligohet Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore që këtë vendim të përfshijë në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunës civile.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

## Arsyetim

Ankuesja \_\_\_\_\_ e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në pozitën Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore sipas akt emërimit të datës 11.07.2017, më datë 23.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2015/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, për shkak të cenimeve të rënda të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa, Këshilli me datë 09.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës dhe me datën 15.03.2023 prova shtesë.

Me Vendimin me numër protokoli 3444/2023 të datës 07.04.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është shtyrë afati për vendosjen e ankesës A.nr.408/2023 të datës 23.02.2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesja M.D drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoli 2015/2023 të datës 23.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës drejtuar Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit dhe Hapësinor me numër protokoli 2214/2023 të datës 01.03.2023; Përgjigje në ankesë drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoli 2145/2023 të datës 09.03.2023; Njoftimin për vlerësimin vjetor të dërguar me E-mail nga M.D për N.A të datës 17.01.2023; Njoftimin për vlerësimin vjetor të dërguar me E-mail nga N.A për M.K, B.B dhe M.D të datës 17.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për M.D ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën 01 Janar-31 Dhjetor 2022 për M.D; Njoftimin për vlerësimin vjetor të dërguar me E-mail nga M.D për N.A të datës 23.01.2023; Ankesën me kërkesën për rivlerësim të rezultateve në punë për periudhën 01 Janar- 31 Dhjetor 2022 të parashtruar nga ankuesja M.D drejtuar N.A Zëvendësues i Udhëheqësit të ARPL-së, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesionale për M.D I datës 24.01.2023; Raporti Janar-Dhjetor 2022: DMRU-ARPL; Formulari- Përshkrimi i detyrave të punës i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vendin e punës Udhëheqës i Divizionit për menaxhimin e Resurseve Ujore të datës 03.07.2017; Dëshmitë e komunikimit elektronik prej 3 faqeve; Rikujtim i dërguar me E-mail nga M.D për N.A të datës 10.11.2022; Informim i dërguar me E-mail nga N.A për M.M I datës 09.11.2022; Informim i dërguar me E-mail nga M.M për [info@goldeneagle-ks.com](mailto:info@goldeneagle-ks.com) të datës 09.11.2022; Informim i dërguar me E-mail nga M.D për N.A me datë 10.11.2022; Informim i dërguar me E-mail

nga N.A për M.D dhe M.M me datë 09.11.2022; Kërkesë për konfirmim të urdhrimit të mbikëqyrësit të dërguar me E-mail nga M.D për S.S me datë 10.11.2022; Kërkesë për procedim të menjëhershëm të dërguar me E-mail nga N.A për M.M me datë 07.11.2022; Letër e hapur e dërguar me E-mail nga N.A për M.D dhe M.M të datës 04.11.2022; Informim i dërguar me E-mail nga N.A për M.D me datë 09.11.2022; Informim i dërguar me E-mail nga M.M për [info@goldeneagle-ks.com](mailto:info@goldeneagle-ks.com); Informim i dërguar me E-mail nga N.A për [info@goldeneagle-ks.com](mailto:info@goldeneagle-ks.com); Informim i dërguar me E-mail nga M.M për [info@goldeneagle-ks.com](mailto:info@goldeneagle-ks.com); Shkresa me korrespondim prej faqe 1-5 të M.D; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S me datë 18.11.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S me datë 18.11.2022; Njoftim i dërguar nga H.K për M.D të datës 11.11.2022; Inicim i procedurës disiplinore i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës ndaj M.D, Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore me numër protokollit 6862/22 të datës 11.11.2022; Shkresë/Vendim i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës me korrespondencë prej faqe 1-7; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S me datë 18.11.2022; Njoftim i dërguar me E-mail nga H.K për M.D me datë 11.11.2022; Shkresë për iniciimin e procedurës disiplinore e dërguar nga H.K për M.D me datë 11.11.2022; Njoftim i dërguar me E-mail nga P.S për S.S, M.D, N.A, H.K, M.Q, V.S, A.S dhe F.B me datë 09.12.2022; Vendim me numër protokollit 8346 I datës 09.12.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës për H.H dhe M.D; Vendim me numër protokollit 8067 i datës 24.11.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës për H.H; Bisedë në aplikacionin Viber drejtuar F.B; Bisedë në aplikacionin Viber drejtuar F.B; Raport i ndërprerjes së përkohshme për punë për M.M nga data 16.11.2022 deri më 21.11.2022; Raport i ndërprerjes së përkohshme për punë për M.M e datës 25.11.2021; Kërkesë për raport deri të premtën ora 12:00 e dërguar me E-mail nga M.D për N.A të datës 08.12.2022; Kërkesë për raport deri të premtën ora 12:00 e dërguar me E-mail nga N.A për M.D; Detyrat e DMRU të dërguar me E-mail nga N.A për F.B me datë 21.11.2022; Detyrat e DMRU të dërguar me E-mail nga F.B për N.A me datë 18.11.2022; Kërkesë për raport deri të premtën ora 12:00 të dërguar me E-mail nga N.A për M.D me datë 10.11.2022; Shkresë për Menaxhimin e Resurseve Ujore me korrespondencë prej faqe 1-3; Kërkesë urgjente për selektimin dhe shpërndarjen e të gjitha lëndëve/aplikimeve për akte ujore dhe vazhdime të lejeve ujore të dërguar me E-mail nga M.D për L.A dhe S.S me datë 12.12.2022; Kërkesë urgjente për selektimin dhe shpërndarjen e të gjitha lëndëve/aplikimeve për akte ujore dhe vazhdime të lejeve ujore të dërguar me E-mail nga N.A për M.D, M.M dhe F.B me datë 06.12.2022; Kërkesë urgjente për selektimin dhe shpërndarjen e të gjitha lëndëve/aplikimeve për akte ujore dhe vazhdime të lejeve ujore të dërguar me E-mail nga N.A për M.M me datë 02.12.2022; Kërkesë urgjente për selektimin dhe shpërndarjen e të gjitha lëndëve/aplikimeve për akte ujore dhe vazhdime të lejeve ujore të dërguar me E-mail nga N.A për F.B dhe L.L me datë 01.12.2022; Kërkesë për takim e dërguar me E-mail nga N.A për M.K, F.B dhe B.B me datë 29.11.2022; Kërkesë për takim e dërguar me E-mail nga N.A për M.K, F.B dhe B.B me datë 29.11.2022; Kërkesë për aprovim e dërguar me E-mail nga N.A për M.M, M.K, S.R, F.B, F.B, S.L, G.D, L.L, A.H, S.V, E.H dhe B.B me datë 29.11.2022; Kërkesë për aprovim e dërguar me E-mail nga N.A për M.M, M.K, S.R, F.B, F.B, S.L, G.D, L.L, A.H, S.V, E.H dhe B.B me datë 25.11.2022; Kërkesë për aprovim e dërguar me E-mail nga S.S për N.A me datë 25.11.2022; Kërkesë për aprovim e dërguar me E-mail nga N.A për S.S me datë 25.11.2022; Kërkesë për aprovim e dërguar me E-mail nga N.A për S.S me datë 15.11.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për M.M me datë 13.12.2017; Kërkesë e dërguar me E-mail nga N.SH për S.R me datë 11.12.2017; Kërkesë e dërguar me E-mail nga S.R për N.SH me datë 07.12.2017; Kërkesë e dërguar me E-mail nga S.R për N.SH me datë 07.12.2017; Kërkesë e dërguar me E-mail nga V.O për N.SH me datë 27.11.2017; Kërkesë për interpretim e

dërguar nga N.SH për V.O me datë 17.11.2017; Kërkesë për interpretim e dërguar me E-mail nga V.O për N.SH me datë 17.11.2017; Kërkesë për interpretim e dërguar me E-mail nga F.B për V.O me datë 17.11.2017; Kërkesë në lidhje me aplikimet për hidrocentrale e dërguar nga G.B për M.D me datë 11.05.2021; Kërkesë në lidhje me aplikimet për hidrocentrale e dërguar nga I.B për G.B, M.M, B.H, S.S, F.K, I.R, SH.D dhe I.M me datë 11.05.2021; Kërkesë në lidhje me aplikimet për hidrocentrale e dërguar nga L.A për I.B, G.B, M.M, SH.D dhe B.H; Kërkesë e dërguar me E-mail nga N.A për SH.D me datë 20.11.2021; Elaborim i shkurtër rreth kornizës ligjore me korrespondencë prej faqe 1-7; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për N.A dhe S.S me datë 16.12.2022; Sqarim i dërguar me E-mail nga M.D për N.A dhe S.S me datë 14.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga N.A për S.S me datë 14.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S dhe N.A me datë 13.12.2022; Kërkesë e dërguar nga M.D për S>S dhe N.A me datë 13.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga L.L për M.D dhe M.K me datë 13.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për M.K me datë 12.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S dhe N.A me datë 21.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga N.A për S.S me datë 22.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga S.S për N.A me datë 22.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S dhe N.A me datë 13.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga N.A për S.S me datë 22.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S dhe N.A me datë 13.12.2022; Sqarim i dërguar me E-mail nga M.D për N.A dhe S.S me datë 14.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga N.A për S.S me datë 14.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S dhe N.A me datë 13.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S dhe N.A me datë 13.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga L.L për M.D dhe M.K me datë 13.12.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për M.K me datë 12.12.2022; E-mail i dërguar nga M.M për M.D me datë 08.12.2022; Vendim-Leje Ujore, Shkarkim I lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër protokollit 3437/2022 me datë 24.10.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr.L.U të datës 20.10.2022; Vendim- Leje Ujore i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër protokollit 4486/21 të datës 20.10.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 14.10.2022; Vendim-Vazhdim i Lejes Ujore i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër protokollit 5673/21 të datës 11.11.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 04.11.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër protokollit 3436/22 të datës 24.10.22; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 20.10.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër protokollit 4485/21 me datë 20.10.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 14.10.2022; Vendim-Pëlqim Ujor i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër protokollit 6057/22 me datë 18.10.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr.PU me datë 17.10.2022; Vendim-Leje Ujore i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër protokollit 5167/22 të datës 20.10.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 14.10.2022; Vendim-Leje Ujore i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me numër protokollit 5098/22 të datës 11.11.2022; Vendim i datës 04.11.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendim-Leje Ujore, Shfrytëzim me numër protokollit 6058/22 i datës 18.10.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendim me numër protokollit 5166/22 I datës 20.10.2022 i lëshuar nga Ministria e

Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendim me Nr.LU i datës 14.10.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendim-Pëlqim Ujor me numër protokolli 5099/22 i datës 11.11.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendim PU i datës 04.11.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendim me numër protokolli 4509/22 i datës 03.10.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendim i datës 22.09.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për S.S dhe N.A me datë 18.01.2023; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për N.A me datë 23.02.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për I.B dhe N.A me datë 07.02.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga F.L për L.A, M.D, I.B dhe N.A me datë 21.01.2022; Vendim i dërguar me E-mail nga M.D për N.A me datë 02.06.2022; Vendim i dërguar me E-mail nga B.T për M.D me datë 31.05.2022; Vendim i dërguar me E-mail nga F.B për B.T me datë 24.05.2022; Vendim i dërguar me E-mail nga M.D për H.L me datë 31.05.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga M.D për I.B me datë 31.07.2022; Kërkesë e dërguar me E-mail nga I.B për M.D me datë 23.07.2021; Kërkesë e dërguar me E-mail nga G.B për M.D me datë 11.05.2021; Njoftim i dërguar me E-mail nga M.D për N.A me datë 05.01.2023; Vërejtje me numër protokolli 7562/22 e datës 12.12.2022 e lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vërejtje me shkrim e dërguar me E-mail nga N.A për M.D me datë 12.12.2022; Sqarim për transferim të përhershëm me numër protokolli 161 të datës 31.01.2023 i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme; Kërkesë për transferim të përhershëm me numër protokolli 02/2023 e datës 04.01.2023 e lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Njoftim pas sqarimit me DMZP i dërguar me E-mail nga H.K për N.A me datë 30.12.2022; Kërkesë për Transferim të Përhershëm me numër protokolli 7691/22 të datës 16.12.22 e lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendim me numër protokolli 5177/2022 i datës 09.09.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Vendim për pushim për M.D i datës 14.12.2022; Vendim për pushim për M.D i datës 21.12.2022; Raport i ndërprerjes së përkohshme për punë i datës 11/12.10.2022; Përgjigje në ankesë e dërguar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për KPMSHCK me numër protokolli 2535 të datës 09.03.2023; Plani vjetor i punës për vitin 2022 i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për M.D për periudhën Janar - Maj 2021 i nënshkruar me datë 07.02.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për M.D për periudhën Maj -Dhjetor; Ndryshim dhe Plotësim i Aktit të Emërimit për M.D me datë 11.07.2017 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Përgjigje në ankese me numër protokolli 2699/2023 e datës 15.03.2023; E-mail i dërguar nga H.K për B.Z me datë 13.03.2023; E-mail i N.A për H.K me datë 08.12.2023; E-mail i dërguar nga F.I për N.A me datë 07.12.2022; E-mail i dërguar nga F.I për N.A me datë 02.12.2022; Kërkesë për plotësimin e përkohshëm të pozitave të lira në ARPL ose kompensim financiar shtesë për angazhimin shtesë të stafit aktual me numër protokolli 5296/22 të datës 16.09.2022; E-mail i dërguar nga N.A për S.S me datë 29.06.2022; E-mail i dërguar nga N.A për I.B me datë 28.02.2022; E-mail i dërguar nga N.A për R.J me datë 11.08.2022; E-mail i dërguar nga N.A për S.S me datë 10.08.2022; Zyrtarët e ARPL-së që janë të angazhuar nëpër-Komitet, Grupe Punuese, Komisione të Vlerësimit, Komisione të Pranimit Teknik, Komisione të Mbikëqyrjeve etj; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën Maj-Gusht 2021 të N.A; E-mail i dërguar nga N.A për S.S me datë 29.07.2021; E-mail i dërguar nga N.A për I.B me datë 28.02.2022; Kërkesë për plotësimin e pozitave në ARLP dhe shpallje të konkurseve për staf të specializuar e datës 01.03.2022; E-mail i

dërguar nga N.A për S.S me datë 25.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për S.S me datë 15.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për S.S me datë 03.10.2022; E-mail i dërguar nga R.J për N.A me datë 28.09.2022; E-mail i dërguar nga A.L për R.J me datë 28.09.2022; E-mail i dërguar nga A.L për J.J me datë 14.09.2022; E-mail i dërguar nga R.J për B.G dhe A.L me datë 13.09.2022; E-mail i dërguar nga M.M për N.A me datë 12.09.2022; E-mail i dërguar nga M.M për M.D me datë ; E-mail dërguar nga N.A për M.D, M.M dhe F.B me datë 06.12.2022; E-mail i dërguar nga N.A për M.M me datë 02.12.2022; E-mail i dërguar nga N.A për M.M, F.B dhe B.B me datë 29.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për M.M, M.K, S.R, F.B, F.B dhe S.L me datë 25.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për S.S me datë 15.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për S.S me datë 15.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për M.D dhe M.M me datë 07.12.2022; E-mail i dërguar nga N.A për M.D me datë 10.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për M.D me datë 07.12.2022; E-mail i dërguar nga N.A për F.B me datë 21.11.2022; E-mail i dërguar nga F.B për N.A me datë 18.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për M.D me datë 10.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për S.S me datë 01.08.2022; E-mail i dërguar nga N.A për S.S me datë 29.11.2022; E-mail i dërguar nga N.A për I.B me datë 28.02.2022; Vendim i datës 01.08.2022 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; E-mail i dërguar nga F.B për N.A me datë 30.11.2022; Lista e kërkesave për shfrytëzim të ujit; Lista e kërkesave për shkarkim të ujit; Lista e kërkesave për koncesion për vitet 2018-2022; Lista e kërkesave për hidrocentrale; E-mail i dërguar nga N.A për S.S dhe R.N me datë 15.09.2022; Zyrtarët e ARPL-së që janë të angazhuar nëpër - Komitet, Grupe Punuese, Komisione të Vlerësimit, Komisione të Pranimit Teknik, Komisione të Mbikqyrjeve etj.; E-mail i dërguar nga N.N për S.S me datë 21.07.2022; E-mail i dërguar nga N.A për I.B me datë 28.02.2022; E-mail i dërguar nga N.A për L.A dhe S.S me datë 09.08.2022; E-mail i dërguar nga A.V për N.A dhe SH.D me datë 22.07.2022; E-mail i dërguar nga R.J për S.S dhe G.K me datë 21.07.2022; E-mail i dërguar nga H.K për S.A me datë 27.03.2023; E-mail i dërguar nga N.A për H.K me datë 27.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësishëm të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e cila sipas Aktit të Emërimit të datës 11.07.2017 ushtron pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore*.

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankueses, me datë 17.01.2023 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2022, me notë të përgjithshme 1.25-dobët, ndërsa pas ankesës më datë 23.01.2023, më datë 24.01.2023 i kthehet vlerësimi nga mbikëqyrësi përmes sistemit me një ndryshim përkatësisht ishte vlerësuar me 1.3-dobët.

Ankuesja e pakënaqur me këtë vlerësim me datën 23.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022 është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë vlerësimin e rezultateve në punë dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, duke shtuar se vlerësimi është tendencioz, jo i drejt dhe subjektiv sepse nuk ka marrë parasysh asnjë prej argumenteve dhe punëve të kryera duke mos respektuar asnjë dispozitë ligjore që përcakton

procedurën e vlerësimit, edhe pse i kam përmbushur të gjitha objektivat sipas përshkrimit të detyrave të punës.

Nga përmbajtja e formularit të vlerësimit në pjesën e komentit të vlerësuesit, konstatohet fakti se Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal i Pellgjeve Lumore, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankueses, ka theksuar faktin se vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses për vitin 2022 e bazon në faktet së ankuesja nuk ka arritur të i realizoj as për së afërmi objektivat e caktuara nga vet ajo në fund të vitit 2021 për vitin 2022.

Ndërsa nga shkresat e lëndës ankuesja në ankesën e datës 23.02.2023 të cilën e ka parashtruar tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejt paraprakisht e pastaj në këshill i ka paraqitur të gjitha objektivat një nga një të cilat i ka realizuar. Pastaj ankesës i ka bashkangjitur edhe Raportin vjetor janar-dhjetor 2022 me të cilin dëshmon se ankuesja ka arritur që ti realizoj objektivat e punës sipas përshkrimit të detyrave të punës, përkundër që vërehet nga përmbajtja e shkresave të lëndës se ka munguar një koordinim përkatësisht mbështetje efektive nga mbikëqyrësi në realizim të këtyre objektiveve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal i Pellgjeve Lumore me datën 11.11.2022 ka paraqitur inicimin e procedurës disiplinore ndaj znj.M.D, Udhëheqëse e Divizionit për Menaxhimin e Resurseve Ujore për : *mospërmbushjen e detyrave të punës, mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave të cilat kanë sjellë pasoja të rënda , moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale, braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo ma shumë dhe shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në shërbimin civil.*

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me vendimin e Datës 09.12.2022 me nr.8346 ka refuzuar si të pabazuar kërkesën me numër protokollit 6862 të datës 11.11.2022 sepse nuk është e bazuar në prova dhe fakte konkrete, për të cilat pretendon inicuesi në kërkesë , meqenëse në dy vitet e fundit e njëjta është vlerësuar në bazë të performancës me nota shumë të mira.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të vendosjes meritore i'u referua nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: 1. *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues.* 2. *Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit.* 3. *Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave.* 4. *Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë..* 6. *Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime më nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.* 7. *Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi.* 8. *Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të.* 9. *Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit....*

Po ashtu Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, përkatësisht nenin 5 ku përcaktohet se : *Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuara; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se zëvendësuesi i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore, në cilësi të vlerësuesit, vlerësimin e ankueses lidhur me rezultatet në punë për vitin 2022 e bazon në rrethanat se ankuesja nuk ka arritur as për së afërmi të realizoj objektivat e caktuara nga vet ajo në fund të vitit 2021, nuk ka realizuar planin legjislativë që lidhet me përgjegjësit e saja, mungesën e administrimit efektiv të lëshimit të akteve ujore administrative, bllokimin e divizionit duke qenë në pushime mjekësore me pagesë dhe pa pagesë ,mungesa e veprimeve të nevojshme konformë përgjegjësi të ankueses dhe çështje tjera në fushëveprimin e institucionit përkatës, ndërsa ndërlidhur me këto fakte, Kolegji nga shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë sipas të cilës dëshmohet se zëvendësuesi i Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore të ketë kërkuar nga ankuesja që të raportoj në baza kohore të caktuara (javore, mujore, apo tre mujore) apo se ankuesja të ketë refuzuar raportimin në bazat kohore të përcaktuara nga vlerësuesi dhe poashtu nuk ka hasur në ndonjë provë që gjendet në shkresat e lëndës përmes së cilës është tentuar të koordinohen përkatësisht të përmirësohen veprimet administrative me qëllim që të realizohen objektivat e caktuara për vitin 2022, përkundër që është obligim i vlerësuesit dhe të vlerësuarit që periodikisht të takohen për të diskutuar realizimin e objektivave nga se kjo çështje është e rregulluar përkatësisht parashihet në nenin 5 paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku specifikisht parashihet: "*Vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuara*", kolegji i këshillit konstaton se nuk ka hasur në ndonjë veprim administrativë të mbikëqyrësit konform kësaj dispozite të potencuar si më lartë, ndërsa edhe deklaratimet e mbikëqyrësit në disa pjesë të vlerësimit të objektivave janë kontradiktore me përmbajtjen e disa shkresave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe nëse marrim për bazë edhe faktin se nga raporti i punës së të vlerësuarës kemi shumë aktivitete të kryera që nënkupton se e njëjta është munduar që të kryejë veprimet konform objektivave dhe se mungesa e koordinimit të veprimeve me vlerësuesin nuk mund të bie barrë ekskluzive e të vlerësuarit, por se kjo është përgjegjësi e përbashkët sa i përket realizimit të objektivave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se divizioni që udhëheqë ankuesja nuk ka miratuar Planin e Objektivave të Punës për vitin 2022 bashkërisht me vlerësuesin përkatësisht me mbikëqyrësin fakt i konfirmuar nga vetë vlerësuesi në komentin e tij me rastin e vlerësimit, ku ndër të tjera konfirmon se objektivat janë caktuar vetë nga ankuesja, përkundër që planifikimi i objektivave përveç që duhet të hartohet bashkarishtë me mbikëqyrësin dhe zbatimi duhet të jetë i kontrolluar në çdo kohë nga mbikëqyrësi dhe poashtu duhet të parashihen edhe aktivitetet për përmbushjen e këtyre objektivave. Rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit përgatitja e Planit të përcaktimit të Objektivave të Punës për sektorin që udhëheqë ankuesja

8-10  
Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave



bie në përgjegjësi të përbashkët të mbikëqyrësit dhe në këtë rast të nëpunëses civile gjegjësisht ankueses në cilësi të Udhëheqëses së fushës përkatëse .Andaj, mos përgatitja dhe mungesa e planit objektiv të përbashkët të punës në mes mbikëqyrësit dhe të vlerësuarit bien ndesh më përcaktimin ligjor sipas nenit 6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, ku në mënyrë shprehimore është paraparë se : *Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuarit) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet. 2. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë. 3. Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit. 5. Në rast ndryshimi të objektivave brenda vitit të vlerësimit, zhvillohet e njëjta procedurë sipas paragrafëve 1 deri 4 të këtij neni për pjesën e mbetur të vitit të vlerësimit.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në deklaratimet si më sipër në arsyetim të këtij vendimi, sqarimin sa i përket realizimit të objektivave që është bërë nga ankuesja në ankesën për rivlerësim të mbikëqyrësi për vitin 2022, raportin e punës për vitin 2022 ku konfirmohet fakti se ankuesja ka ndërmarrë veprimet me qëllim të zbatimit të objektivave konformë përgjegjësi që ka pasur ,komunikimet që ka pasur me zyrtarët kompetentë me qëllim të realizimit të objektivave e që gjinden në shkresat e lëndës, vlerësimet e viteve paraprake 2020 dhe 2021, me ç’rast vërtetohet fakti se e njëjta ka qenë e vlerësuar për periudhën Janar-Dhjetor 2020 me notë mirë(3), ndërsa për periudhën Janar-Maj 2021 me notën shumë mirë (4), periudhën Maj-Dhjetor 2021 me notë shumë mirë(4.13),fakte të konfirmuara në vendimin e komisionit disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të datës 09.12.2022 në lidhje me inicimin e procedurës disiplinore nga mbikëqyrësi për ankuesen, me ç’rast përveç tjerash është marrë edhe me konstatime që lidhen me fushat që lidhen me realizimin e objektivave të caktuara dhe përmes këtij vendimi ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankueses duke qartësuar njëkohësisht me konstatime se ankuesja nuk ka ndonjë përgjegjësi individuale në lidhje me çështje të caktuara të realizimit të objektivave e që ndërlidhen me objektin e kësaj ankese, pra komisioni disiplinorë meritorishtë i ka qartësuar disa elemente që kanë qenë përmbajtësore me rastin e vlerësimit nga ana e mbikëqyrësit dhe mbi bazë të provave të administruara nuk ka konstatuar ndonjë përgjegjësi sa i përket realizimit të objektivave të caktuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës dhe nga konstatimet si më sipër rezulton se vlerësimi i ankueses me notën e përgjithshme 1.3-*mjaftueshëm* nuk është vlerësim i drejtë dhe real dhe nuk përkon më detyrat e realizuara konformë objektivave të vendosura, rrethana të konfirmuara nga shkresat e lëndës dhe të potencuara si më lartë, kështu që Kolegji në mbështetje të nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: *“Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)..”*,vendosi që të ndryshoj Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022, për ankuesen, ashtu që nota e përgjithshme përfundimtare njëpikëtre (1.3), ndryshohet me notën e përgjithshme përfundimtare tre (3), e që në kuptim të nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të

Shërbimeve Publike, nota nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton vlerësimin "mirë", ngase siç u konstatua më lart ankuesja ka argumentuar mjaftueshëm me prova materiale se ka realizuar detyrat e punës dhe ka treguar gjithashtu aftësi të pritshme të punës, fakte të konfirmuara siç e thamë më lartë edhe nga organet kompetente të vetë Ministrisë Përkatëse përkatësisht vendimit të komisionit disiplinor të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të datës 09.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.408/2023, datë 26.04.2023.

Sabile AVDYLI  
*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së;